



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/1
Nr. ___/Prot.

Tiranë, më 28. 10. 2025

URDHËR

Nr. 550, datë 28.10. 2025

PËR

MIRATIMIN E PLANIT MËSIMOR TË GJIMNAZIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës "b" të pikës 2 të nenit 45 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të shkronjës "dh" dhe "e", të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar" dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani",

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit mësimor të gjimnazit sipas shtojcave 1 dhe 2, si dhe rregullave për zbatimin e tij sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
 2. Ky plan mësimor fillon zbatimin si vijon :
 - a) Për klasën e dhjetë në vitin shkollor 2026-2027;
 - b) Për klasën e njëmbëdhjetë në vitin shkollor 2027-2028;
 - c) Për klasën e dymbëdhjetë në vitin shkollor 2028-2029.
 3. Planin mësimor i gjimnazit, i miratuar me shkresën nr.12789/1 prot., datë 28.12.2017, shfuqizohet sipas fillimit të zbatimit të planit mësimor në klasat e sipërcituara.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Adresa: Rruga e Durrësit, nr. 23, AL 1001, Tiranë. E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Shtojca 1. Plani mësimor i gjimnazit (në orë mësimore/javë)

Nr.	FUSHAT DHE LËNDËT	KLASAT		
		KLASA X (Orë mësimore /javë)	KLASA XI (Orë mësimore /javë)	KLASA XII (Orë mësimore /javë)
1.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	7	7	7
1.1	Gjuhë shqipe	2	2	2
1.2	Letërsi	2	2	2
1.3	Gjuhë e huaj e parë	3	3	3
2.	MATEMATIKA	4	4	4(B) ose 6 (A+B)
2.1	Matematikë	4	4	4(B) ose 6 (A+B)
3.	SHKENCAT E NATYRËS	6	6	
3.1	Fizikë	2	2	
3.2	Kimi	2	2	
3.3	Biologji	2	2	
4.	SHKENCAT SHOQËRORE	6	6	3
4.1	Shkenca sociale (Qytetari, Filozofi)	2	2	
4.2	Histori	2	2	
4.3	Gjeografi	2	2	
4.4	Ekonomi			3
5.	TEKNOLOGJIA DHE TIK-U	2	1	
5.1	TIK	2	1	
6.	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3
6.1	Edukim fizik, sport dhe shëndet	3	3	3
	KURRIKULA BËRTHAMË	28	27	17-19
7.	KURRIKULA ME ZGJEDHJE (Lëndët sipas shtojcës 2)	2	3	11 - 13
8.	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE (Rregullat në shtojcën 3)	1 - 2	1 - 2	0 - 2
	TOTALI (ORË JAVORE)	31-32	31-32	30-32

Shtojca 2: Kurrikula me zgjedhje e gjimnazit

Nr.	KURRIKULA ME ZGJEDHJE	KLASAT		
	Fushat dhe lëndët	Klasa X (Orë mësimore /javë)	Klasa XI (Orë mësimore /javë)	Klasa XII (Orë mësimore /javë)
1.	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	2	2	6
1.1	Gjuhë shqipe			2
1.2	Letërsi			2
1.3	Gjuhë e huaj e dytë	2	2	2
2.	MATEMATIKA			2(A) ¹
2.1	Matematikë			2(A)
3.	SHKENCAT E NATYRËS			12
3.1	Fizikë			4
3.2	Kimi			4
3.3	Biologji			4
4.	SHKENCAT SHOQËRORE			12
4.1	Shkenca sociale (Sociologji, Psikologji)			2+2
4.2	Histori			4
4.3	Gjeografi			4
5.	ARTET	2	2	2
5.1	Teatër ose Muzikë ose Art pamor	2	2	2
6.	TEKNOLOGJIA DHE TIK-U		2	4
6.1	TIK		1	2
6.2	Baza inxhinierike dhe Teknologji		1	2
7.	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	1	1	1
7.1	Edukim fizik, sport dhe shëndet	1	1	1
8.	MODULET KURRIKULARE	2	2	Maksimumi 8

¹ Nëse nxënësi zgjedh matematikën e avancuar (A) ajo zhvillohet së bashku me matematikën bazë (B) si një lëndë e vetme.

Shtojca 3. Rregulla për zbatimin e "Planit mësimor të gjimnazit"

1. Në klasën e 12-të, për lëndën "Matematikë", nxënësit mund të zgjedhin brenda kurrikulës bërthamë, programet sipas niveleve: A (ku A është niveli i avancuar së bashku me nivelin bazë) dhe B (ku B është vetëm niveli bazë).
2. Në kurrikulën bërthamë të fushës "Shkencat shoqërore", lënda "Qytetari" zhvillohet në klasën e 10-të dhe lënda "Filozofi" zhvillohet në klasën e 11-të, ndërsa në kurrikulën me zgjedhje në klasën e 12-të, nxënësi mund të zgjedhë të zhvillojë njërin prej lëndëve (Sociologji/Psikologji) ose të dyja së bashku (Sociologji dhe Psikologji).
3. Fusha e Arteve në kurrikulën me zgjedhje përbëhet nga tri lëndë: Teatër, Muzikë, Art pamor, të cilat mund të ofrohen si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, të pavarura nga njëra-tjetra.
4. Fusha "Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti" në kurrikulën me zgjedhje, përbëhet nga disiplinat Aerobi (klasa e 10-të), Fitnes dhe shëndeti (klasa e 11-të) dhe Kondicioni fizik (klasa e 12-të), duke i dhënë nxënësve hapësirë të zgjedhin sipas interesit dhe potencialit të tyre, për të fituar përvojë të reja në këtë fushë.
5. Në fushën "Teknologji dhe TIK" në kurrikulën me zgjedhje, lënda "Baza inxhinierike dhe Teknologji" mund të zgjidhet në klasën e 11-të dhe /ose në klasën e 12-të: Baza inxhinierike në klasën e 11-të me 1 orë mësimore në javë, Teknologji në klasën e 12-të me 2 orë mësimore në javë, të cilat mund të zgjidhen të pavarura nga njëra – tjetra.
6. Në planin mësimor të gjimnazit, numri total i orëve javore është deri në 32 orë mësimore në javë për secilën klasë, ndër të cilat 30 orë mësimore në javë shkolla i plotëson detyrimisht me kurrikulën bërthamë dhe me zgjedhje të detyruar, ndërsa deri në 2 orë mësimore në javë shkolla mundëson zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle për projekte ndërkurrikulare, shërbim komunitar apo veprimtari të tjera shkollore.
7. Në gjimnaz, nxënësi ka detyrimin të zhvillojë 30 orë mësimore në javë gjatë çdo viti shkollor, 18 orët e shërbimit komunitar dhe 18 orë projekt ndërkurrikular. Shërbimi komunitar dhe projekti ndërkurrikular zhvillohen në klasën 10-të dhe/ose në klasën e 11-të.
8. Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara për nxënësit. Ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me veprimtari të tjera shkollore, module kurrikulare.
9. Kurrikula me zgjedhje hartohet në nivel qendror, plotëson dhe zgjeron kurrikulën bërthamë, sipas politikave kurrikulare dhe interesave të nxënësve. Kurrikula me zgjedhje përfshin një menu lëndësh dhe modulesh kurrikulare, nga të cilat nxënësit mund të zgjedhin duke u bazuar në interesat e tyre. Lëndët ose modulet kurrikulare të zgjedhura në kurrikulën me zgjedhje zhvillohen njësoj si lëndët e tjera të kurrikulës bërthamë.
10. Kurrikula në bazë shkolle është pjesë e kurrikulës së përgjithshme e cila, në dallim nga kurrikula bërthamë dhe kurrikula me zgjedhje, nuk është e detyruar të zgjidhet nga nxënësit (përveç orëve të shërbimit komunitar dhe orëve të projektit ndërkurrikular). Kurrikula në bazë shkolle zhvillohet brenda kohës së përcaktuar në planin mësimor, në përputhje me interesat dhe me nevojat e

nxënësve, si dhe me mundësitë e shkollës, specifikat rajonale, kërkesat e kohës. Kurrikula në bazë shkolle është pa vlerësim me notë.

11. *Modulet kurrikulare si pjesë e kurrikulës me zgjedhje ofrohen vetëm nga lista e moduleve kurrikulare të publikuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar.*